

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

Xhevahir Cirongu

Sikur ta prekja diellin

Poezi

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

Titulli i librit:

Sikur ta prekja diellin (Poezi)

Autor:

Xhevahir Cirongu


Redaktor : Lorenzo Manca

Kopertina: Jozef,Dizan

Botime,Jozef , Durrës 2020

ISBN 978-9928-317-22-3

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi



Nëna ime e shtrenjtë: Në lotin i syrit kam
shkruar EMRIN TËND, në Zemër fjalën e
DASHURISË, në shpirt DRITËN E
PËRJETSISË!

Autori

Durrës, 5 TETOR 2018

NË BRIGJET E SHPIRTIT

Lamtumirë, o mik i dashur

Ike pa më folur si flladi i erës,

Nëpër rrugët e grisura të botës.

U tretën mendimet në çdo fjalë

Ashtu, mbi qepallë të përgjumura,

Lumturia e dashuritë qëndisur në shami.

Por, prapë o mik i dashur ti erdhe

Me lamtumirën e diellit – dashuri,

Si dallgë deti vrapuan tek unë

E qëndruan në brigjet e shpirtit tim.

Durrës, 13 Maj 2016

PUTHJET ATY NGELËN

Vështrova tutje në horizont mes reve

Dhe zgjata si shtizë krahët t'i prekja ato,

Ashtu, pa dashur m'u thyen si një pasqyrë

Mendimet dhe ëndrrat tek ajo re.

Pse vallë ndodh kështu te ty o njeri?!

Sa herë ëndërron për të puthur ato re,

Të treten mendimet e të humbasin në horizont,

Eh, kështu qënka thënë, nesër do bëhemi dhe.

Prapë, tutje vështrimet i ndala te ajo re

Si dy të dashuruar nga larg ne u përqafluam;

Dhe zjarrin e dashurisë atje mes reve

Asaj dhe mua në kaltërsi puthjet aty ngelën.

Durrës, 5 Qërshor 2016

ESHTRAT E PËLLUMBIT

Eca, ashtu ngadalë mbi atë lëndinë

I vetmuar dhe me plagën - trishtim,

Edhe gjethet e pemëve ishin zverdhur si dylli

Që të dy, as vet s'e dinim ç'kish ndodhur

Një tragjedi fshehur ajo lëndinë mbante në gji.

Ishte kohë e largët që kish ndodhur, sigurisht

Rëkonte toka dhe eshtrat nga ajo tragjedi,

Një korb i pashpirt i zuri besës pusi

Ah, atij pëllumbi të paqes i vrau

Të shtrenjtën – Liri!

Kohët e largëta si hekuri ishin ndryshkur

Sigurisht, edhe lulet aromë s'kishin më;

Te eshtrat e pëllumbit të paqes

Lotin e hidhur dhe ngushëllimin e fjalëve

U linin eshtrave çdo ditë aty.

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

U lutem, hapeni atë varr pëllumbi
Këmbanat e shekujve aty dëgjohen edhe sot,
Te hapi im, koha histori na thërret
Pëllumbi dëshmor ka vetëm jetë.

Hapeni atë varr o njerëz të mirë
S'e në eshtrat e gjoksit të atij pëllumbi;
Do të gjeni të shkruar me gjak
Fjalët plotdritë: Atdhe, shqiponjë e Liri!

Durrës, 9. 06. 2016

TE LULET E BLIRIT

M' u shfaqën ëndrrat, ashtu pa pritur

Te liqeni i kaltër i shpirtit tim,

Zambakët e bardhë vallzonin atje

Dhe vesa nëpër fije bari

Putheshin nën rrezet e arta të diellit.

Më prit e dashur, bëj pak durim

Nëpër rrugët e atdheut do ecim të dy;

Te lulet e blirit u rritën dashuritë

Dhe yjet buzëqeshnin e përqaфонin fëmijët.

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

Si flutur erdhi dhe ëndrra dashuri
Zambakët e bardhë këngës ia thanë,
Liqeni i shpirtit ëndrrat mbante në gji
Rrugëve të atdheut do të ecim gjithmonë
Padyshim , unë edhe ti.

Dhe ëndrrat u bënë tinguj violine
Zambakët e bardhë në liqen krahapur rrinin;
Valët vallzonin me të dashurën dashuri
Ndërsa kënga e zogjve dëgjohej tutje në hone.

Durrës, 12 Prill 2016

PUTHJET LAMË PAS

Me dashuri vështrova qiellin e kaltër vjeshtak
Dhe rrezet e diellit ishin larë me vesën e mëngjesit,
U tretën shikimet e mija tutje në gjoksin
E gjakosur të diellit në perëndim !...
Ah, sikur edhe unë të fluturoja
Si retë e bardha shtegëtare në horizont;
Të prekja butësisht rrezet e diellit
Pastaj, le të puthja buzët e reve pafundësisht.
Ndalova pak çaste te syri i qiellit të kaltër
Me retë e bardha sërish zura të flas,
Si dashuria e nënës që puth fëmijën në vatër
U përqaftuam me retë, e puthjet lam pas.

E martë, 30 Gusht 2016

KOHË E KRISUR

Kohët ecin e mbledhen si një grusht

Brenda tyre dhe ne shtrydhur

Si një bistak rrushi që rrjedh musht.

Sa herë që hapet grushti i kohës

Plagët, ndoshta nga dhimbja,

Nën zë tregojnë çdo rrëfenjë.

Ah, zemra e shkretë s'më gënjeu

Si gur i ftohtë koha më ngjau!

Iku e më s'u pa,

Si puhizë deti përkëdheljen aty la.

Kohë e krisur në shteg të vetmisë

Qëndron te një pemë pa lëvore,

Veshur me këmishë linoje të bardhë.

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

Si teu i thikës mes reve të kuqërremta
U ngjanin ëndrrave të lyera në gjak,
Marrëzisht dhe koha e krisur
Qe bërë e hollë si letër varak.
Atëherë kupton i shkreti njeri
Koha qënka tinxare , e krisur,
Sa edhe vdekjen e paskemi hak!

dt. 17 Tetor 2016

MOT E JETË NË LIRI

I shtrenjti Atdhe të dua
Si rrënjët e lisit
Në pavdekësi.
Dhe trangu i trupit tënd
Mbuluar me plisa të bardhë,
Pastaj, me mall e dashuri
I utha në pafundësi me radhë.
Shqiponja krahët i hapi
Atje mbi gurë stralli,

Shkëndija zjarri u ndezën,
Në sfondin e flamurit
Kuq e Zi,
Dhe me gërma të arta
U shkrua 28 Nëntori.

Nëpër shekuj u derdhën
Lumenjë gjaku,
Me qindra fjalë urime
Vrapuan atje për tek ty.
Dhe Vlora sy kaltër
Kombit i këndoj këngën
Mot e jetë në Liri!

Durrës, 11 Nëntor 2016

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

*Devolli heshti!? ...Por... Dritëroi jep dritë ,sepse ai na
la fjalën e shkruar të bukur shqipe!*

DRITËRO AGOLLIT

E ndali rrjedhën Devolli plak
Në plisin e dheut derdhi lot,
Thinjave të flokëve u dha hak
Te vargu ylldritë të poetit
Me dhimbje ato i puthën atë çast.

Devolli heshti, heshti , heshti!
Dhe vala s'tha dot një fjalë,
Lirikut të fjalës iu drodh dora
E ndjehu edhe pena dhimbjen
Nga ky çast ajo zuri të qajë!

Devolli heshti, s'kishte më valë
Gjithë lulet e shkurtit atë çast qanë,
Ikonës së fjalës të bukur shqipe
Dritëro Agollit lamtumirë i thanë!

Durrës , e premte, 3 Shkurt 2017

TINGULLI I FJALËS

*“...Kur vdes këngëtari, tingulli i melodisë vajton trishtueshëm
saqë edhe guri derdh lotin e ftohtë! Ngushëllimet tona familjes
e të afërmve ju përejellim në këto çaste hidhërimi!”*

(Françesk Radit, 03 prill 2017)

Kur bie muzgu i natës
Gjithë yjet ndizen si zjarre,
Atëhere, fjala zë e flet me natën
Dhe tingujt flenë nëpër pentagrame.

Zgjoju pak çaste të lutem
Nga gjumi e shtrenjta fjalë,
Të gjithë yjet supeve nguten
Pastaj vrapojnë tek e bardha valë.

Ëndrrat e yjet erdhën tek ti
Pranverës i thanë jemi aty,
Me krahë u bë tingulli i fjalës
Gjithë dashuritë e botës, erdhën tek ty!

KOHA SHTRIGË

Ecim ngadalë mbi shinat e kohës
Dhe vrapin lokomotiva diku qëndron,
Ashtu si bisqet e luleve të vjeshtës
Nga lodhja gjymtyrët e trupit rënkojnë.

Koha e dielltë ne seç na ngrohu
Ajo na fal dritë, frymarrje e tingull,
Por koha shtrigë stacion ndryshon
Si gjethet e varura të thata të palmës
Gjymtyrët tanë na i lëshon.

Në udhën e gjatë të kohës jetë
Ajo të errta re diku i ndalon,
Si një kal i zi pa fre pas nesh vrapon
Hirin e kockave një ditë ajo hedh
Në shtratin e lumit bie e fle.

As vet si besoj kohës kryeneç
Në heshtje vajtimi si dy binjak,
E shqyej trishtimin, gëzimin përqafoj
Gjymtyrët e hirtë të kohës
I hedh në det,
Me ato zë nis e lundroj.

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

Ne ecim me tingullin e kohës
Pa dashur as vet s'e dimë, ka edhe stuhi!
Tek ai gur i bardhë në kodër varri
Natë e ditë ashtu në heshtje
Të vdekurit i nderon ajo selvi.

Ah, kështu qënka e thënë
Në këtë botë shtrigë,
Koha - shtrigë kackat pabesisht
I thyen e hi na i bën përsëri.

Durrës, 3 Mars 2017

ÇAPITET XHELOZIA

Ashtu si moçali me ujë të ndotur
Çapitet i gjori xheloz çorape grisur,
Mendimet pa bosht i lëshon në ajër
Dhe fjalët si gunga në mur i rrinë varur.

Më kot mundohet të fajsojë të tjerët
Tek sytë i lexohet qartë xhelozia,
I lodhur çapitet në kopshtin me gjemba
Në kullën e shpirtit i është fikur drita.

Nga dehja i janë mbyllur shtigjet e gjitha
As vet se kishte menduar ç'po ndodhte,
Sa edhe parmakët e drunjta të shkallëve
Nga xhelozia kockat e trupit i qenë thyerë.

Veç dimër i çapitet nëpër syt e tij
Dhe lulet e shpirtit në vazo tharë,
Xhelozët dinë të thonë vetëm një fjalë
Edhe të mirët iu duken si të marrë.

Si algat në pellgje me ujë të ndotur
Kopjaci e xhelozit me to aty noton,
Dhe shpifjet e fjalëve i zgjat pa fund
Si hunda e kërmillit kur ecën në bar.

Kështu qënka e thënë në këtë botë
Gjithë xhelozët çapiten humnerës
Edhe mburrjen e quajnë fat!

Durrës, 16 Mars 2017

NDJENJAT E STINËVE

Sa herë që vjen dimri
Edhe koha e trishtë troket;
Tek unë gjithë përenjtë zbrazen
Në shpirt ai plagët mi gjen.

Por prilli me lule çelur
Lëndinës së shpirtit lulëzon,
Ai të bukura ditë na fal
Buqetë gëzimesh me lule dhuron.

Pranvera mes gëzimesh ecën
Dhe verën motër rrugës takon,
E puthin me endje yllin polar
Dhe si flutur në shpirtin tim
Të dyja ato aty vallzojnë.

Dhe vjeshta me musht shege
E lag çdo ditë trupin tim ,
Atje takohen të katra stinët
Dhe jetë i japin shpirti tim.

Durrës, 20 Mars 2017

EJA, AFROHU..!

Seç fryhu lehtë puiza e erës
Ngadalë shkundi pjalmin e luleve të fushës;
Dhe vala e detit zgjat duart lozanjare
Me buzët si të petaleve
Më puthën butësisht gushës.

Dhe valët e bardha nga deti
Si fluturat m'u ulën mbi qepallë;
Si yjet e qiellit qëndisur
Zjarre ndriçuar mbi ballë.

Eja, afrohu ashtu ngadalë
Te flokët kaçurrela aty qëndruan;
Si kënga që del grykës jehonë,
Dhe flokët e verdha nën zë seç thanë
Mbi ne supeve bashkë
Edhe lulet lejla butësisht aty ranë.

Durrës, 27 Mars 2017

KOHA NË UNIVERS..!

Eja me mua e dashur kohë,
Si krahët e zogjëve krah hapur
Fle mbi mua.
Ndaj të pres çdo ditë te shtegu i dhive,
Edhe tik – taket e orës kohë
Me grusht pinë ujë
E shuajnë etjen atje në krua.

Tutje në univers shohë dritë e shpresë
Dhe dielli mëngjeseve na përshëndet,
Koha e ora jetë si binjak lahen me vesë
Të dyja i duam , sepse na falin shpresë!

Ndalon ora e koha
Ato na sjellin edhe furtunë;
Juve që u fala dritë e lumturi
Bashkë me shpresën jetë
Një ditë do ktheheni tek unë.
Do të jeni bashkë përgjithmonë:
Koha,
Dielli,
Hëna,
Dhe ju o njerëz
Atje nëpër univers..!

Durrës, 6 Prill 2017

MË FOLI LULJA BEGONJA

Sapo kishte çelur ajo lule
Petalet krah hapur puthnin diellin,
Aroma e saj të kundërmontëte
Mbi buzët e mija pjalmi kish' ngelur.

Tek ajo dritare në parmak saksia
Përherë më përshëndet Begonja,
Mëngjeseve aroma më zgjon nga gjumi
Dhe mbrëmjeve qetësisht me atë flija.

Ajo më flet me aromë maji
Dhe unë thyej heshtjen asaj i flas,
Lulet e majit syçelura thurur gërshet
Aty frymon, domosdo vargi im si poet.

Rrugicës së lagjes bie një këmbanë
Fëmijët buzëqeshur si diell maji,
Tek vatrat si zjarre tregohet përrallë
Me njerëzit e poetin Begonja përqafuar!

Durrës, 10 . 04. 2017

Shënim: Begonja, lule që rritet në vazo.

Ç ‘ PATËN YJET E NATËS

Të thash se do të vija,
dhe ti më prisje me krah hapur!
Sa dhe ngjyrat e ylberit në qiell
me fjalë e premtimet bashkë
nga përmballimi
u përqaftuan atje në krua.
Ç ‘ patën yjet e natës?!
Të trebur zbritën nga kupa e qiellit,
sa dhe fjalët me ngjyra ylberi
ato të gjitha u dehën,
dhe etjen e dashurisë
tek ai krua e shuan.
Dhe yjet e dehur nën zë uruan
në vetminë e natës pa zhurmë,
në gotën e qelqtë me ujë
tek ne të dy ndriçuan
dhe fjalët e zjarrta
etjen aty e shuan.

Durrës, 2 Maj 2017

LIQENET E SYVE

Nga sytë e trandafilave
Ngadalë rrodhën pika loti,
Atje te gurët e dashurisë pastaj
Ëndrrat e jetës u thurën si gërsheti.
Ju lotët e mij ndaloni një çast
Uluni këmbëkruq në paqyrën e djalërisë;
Nga aty vështroni rrudhat e kohës plakë.

E ndjej thellë në brigjet e shpirtit
Lotin e kripur të jetës Dashuri!
Të lutem, prit edhe pak
Kur loti të bjerë në pëllëmbë të dorës
Atëherë do më japësh
edhe mua hak.

Liqenet e syrve do thahen
Dhe loti në pasqyrë do bëjë dritë,
Ja kështu, te i ëmbli lot
Jetojnë gjithmonë Dashuritë!

Durrës, 30 Qërshor 2017

**ALEPPO, ALEPPO ME VARGUN
THËRRAS**

E çuditshme qenka kjo botë tinxare
Vrapon si një e çmendur nëpër Aleppo,
Meteorët egërsisht ranë mbi pallate
Ah, edhe fëmijët larë në gjak e lot!
Një zë fuqishëm pastaj thërret:
Na e vranë nënëmirën me emrin Teto!

Vargjet e mia po t'i dërgoj ty Aleppo
Të veshura me plagdhimbje e dashuri,
Sa dhe guri i shqipës qau për ty
Për të gjallët e të vdekurit atje në varre
Nga larg udhëtuan e u takuanë në dilërsi.

Me kostumin e zi kobëzeza sorrë veshur
Aleppos i vrau kulturën dhe shpresën,
Drithërima zërash njerëzish në qiell
Te yjet aty janë derdhur.
Me rreze të ngrohta dielli
Dhe vargjet e mija i dërgova në Aleppo,
Të shëroj plagdhimbjet e trupit
Që e nesrma e lirë të flas për jetën.
Dhe vargu im le të bëhet dritë
S'e nga gjaku i yt është larë,
Si dy të dashur u puthën ngadalë.
E djeshmja e thau lotin e hidhur
Aleppo, Aleppo vargu im do thërras,
Liri- jeto e lirë s'e je larë me gjak!

Durrës, 21 Dhjetor 2016

ATJE ANIJET FLENË

Mbi valët e detit anijet rrinë të heshtura
Si retë në qiell takohen shpesh te bregu,
Pikjadë në det litarët si gjerdanë janë varur
Anijet dhe valët menduar kapur si pengu.

E ndjente lartë në qiell dhe reja
Sa shumë vuajtje tek ata që dhemb,
Dielli rri fshehur tek buzëmbremja
Peshkatarëve sakaq zemra seç iu shemb.

Me dhimbje peshkatarët përkëdhelin
Luspat e peshëqeve që rrëshqasin si petëdalë,
Si gishtat në tastier lëvizin e ngadalë
Një e nga një në det zhyten në të bardha valë.
Spirancat presin të nesërmen të zgjohen
Të nisin sërshit nëpër det lundrimin e radhës,
Si një gjysëm harku hëne, atje anijet flenë.

Heshtjes së përgjumur atje në breg
Anijet e valët puthen si fëmijët,
Pa dashur vjen me mall dita e re
Anijet do nisen nëpër det tek ato re.

Durrës, 28 Nëntor 2016

NA PRET E BARDHA VALË..!

Ja edhe ditët e korrikut me zheg
Ngarkuar me rreze dielli si ari,
Te vala e deti atje në breg
Fustanella e bardhë valllen atje ndali.

Zhegu i vapës i tha valës tek unë eja
Dhe rrezet e dielli në perëndim përflakur,
Si lulëkuqet rrezet u shkundën në rërë te bregu
Te fresku i valëve gjysëm harku.

U tret vapa e korrikut te fresku valë
Atje nën rërë lulëkuqet flakëndezur,
Te guackat e detit dashuritë lanë.

E nesrma do vijë prapë
Me ditë korriku plot zheg,
Na pret e bardha valë gjithë nur
Varka s' do heshti më atje në breg.

Durrës, 12 Korrik 2017

METAFORA E FJALËS

Ashtu si vera e bardhë
Kur hidhet në gotën e qelqit,
Te fjala e shpirtit tonë rrinë
Të gjitha metaforat e vargut.

Seç fryn puiza e erës vjeshtake
Dhe fjala me aromë molle dehur,
Për te vargu i poetit ecte
Diku shtigjeve të jetës
Nëpër degët e pemëve ngecur.

E dua metaforën e fjalës
Ajo gjumin e bën në fole zogjësh;
Në gotën gjen verë e vesë
Saqë vargjet e poetëve bëhen
Si mjalt në koshere bletësh.

Poetëve metaforat seç u rrinë
Gjithmonë në shpirt menekshe,
Çuditrisht ato s'heshtin kurrë
Deri skuteve edhe nën dhe.

Durrës, 23 Korrik 2017

U NDEZËN NEONET

Ashtu si e përgjmur
Erdhi edhe mbrëmja mbi qytet,
Me lotin e kuq në syrin e ndezur
Në horizontin e detit lamtumirën dielli e la.

Me hap të ngadaltë
Muzgu i mbrëmjes erdhi mbi qytet,
U ndezën neonet trotuarve
Dëgjohen pëshpërimash fjalësh nga njerëzit
Në këtë natë vere gushti
Dhe yjet nga vapa heshtnin.

Të pres çdo mbrëmje krahapur
Gjumin ta bësh o natë në krahët e mi,
Sakaq tek ai neon i bardhë
Fole zogjësh e putheshin si fëmi.

U ndezën neonet në atë qytet
Të qeshur njerëzit rendnin pas dritës neon;
Vajzat me flokë kaçurrela dallgëzuar si valë deti
Bashkë me djemtë mbrëmjeve rrugicave ecnin
E puthjet ndezur i linin te ai neon.
Eh, sa i duam dritat neon
Kur mbrëmjeve qytetit i japin bardhësi,
Sepse te ai lot i kuq i diellit në perëndim
Gjendet e shkruar magjikja fjalë : Dashuri!

Durrës, 17 Gusht 2017

HESHT!

Hesht
heshtja,
dhe..ikën pa e kuptuar
në heshtje....!?
I them heshtjes:
Pse hesht?
As një fjalë
e përgjigjen marr prej saj
vetëm heshtje.
Hesht!
hesht!
tek ajo do gjesh
në heshtje
mendim e fjalën
dhe prapë
ajo vetëm hesht!?
Pse hesht – heshtja?
kërkoj prej saj
një fjalë,
të më thotë:
“edhe unë mbaj të fshehur
tingullin fjalë!”
Hesht- heshtja
në vaskën e saj
mban të fshehura
miliona fjalë.

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

Hesht – heshtja
ajo di të flasë
vetëm at'herë
ku njerëzve u duhet
e bukura fjalë.

Hesht – heshtja,
dhe në heshtje
na flet të gjithëve
me filozofinë e dritës fjalë.
Vetëm at'herë
e shkruar në shkëmb e gur,
hesht – heshtja
Hesht!
hesht!
gjithë mjaltë e nur.

Durrës ,20 Gusht 2017

MË DEHU ERA E VJESHTËS

Era e detit befas tek unë erdhi
Me mall dallgësh ajo më përqafoj;
Buzëqeshjen e puthjen e ndezur
Më la në buzë, pastaj s'e di nga shkoj!

Është erë vjeshte dhe bën pak ftohtë
Në perëndim retë gri varur seç rrinë,
Vajtueshëm nga qielli papritur pikon lot
Kjo vjeshtë e parë sërish seç zuri të qajë.

Natyra e zhveshi kostumin e gjelbër
Era e detit e dehur prap erdhi,
Me të zjarra ngjyra i veshi pemët
Te ngjyrat e gjetheve të vjeshtës
Edhe Van Gogh e ngjeu penelin.

Gjithë ngjyrat e fustanit vjeshtak
Vallzojnë nëpër degët e pemëve,
Sa bukur i shkon vjeshtës kostumi i artë!
Marrëzisht më dehu era te Ura e Psherëtimave ,
Dhe shirat e vjeshtës sërish u kthyen prapë.

Durrës, 02 Tetor 2017

Shënim: Ura e Psherëtimave , Venecie, Itali.

Piktur Holandes, Vincent Van Gogh

NA FTON SHEKULLI I RI...

Atje në lindje ku dielli përflak
Vjeshta u ul këmbkryq mbi lumin Jance,
Një zë më thirri e ndali tek unë pak
Vargu i trishtimit aty ende seç pikonte;
Dhe...sakaq vargu i poetit Du Fu
E puthtëte e dhe e përqafontëte...!

...Dhe drama mizore luante me fatet
Tek mjegullat lart në malin Jingtin;
Ç'kishte ndodhur me fatet njerëzore?!
As vet s'e di,e sërisht mali seç u ngjall
U zgjua me vargun e poetit Li Boi.

Vargjet e poetëve të lashtësisë
U bënë njësh me lumin Jance ,
Bashkë me erërat e malit Jingtin,
Perandoritë ngrihen e bienë
Si gjethe vjeshte në rrugëtim.

Dëshmia historike fle tek ai mur Kinez
Veç vargjet e poetëve suferinës qëndruan;
Sa edhe sot ato janë si shpirt i hajmalisë.

U grisën perandoritë si cerga merimangash
Eja, si rreze dielli ngjyrë gjaku në perëndim
Të flasësh me valët e Lumit të Verdhë,
Na fton të gjithëve ky shekulli i Ri
Jo, s'do të thotë, se kjo është hipokrizi.

Durrës, Tetor 2017

M'I VODHI GJETHET

Ashtu në qetësi si pa u ndjerë
Iku dhe vjeshta, si kripa u tretë,
Këmishën e verdhë kish' zhveshur
Bliri jetim te rruga mbetur vërtetë.

I folën blirit , ai njerëzve diçka u tha,
Kjo erë e vjeshtës, m'i vodhi gjethet;
Nga degët ia shkundi gjethet e verdha
Ashtu si valët e detit filluan drithërimat.

U lodha duke numëruar me radhë gjethet
Dhe bliri kishte rënë i gjithi në qetësi,
Të përgjumur në qytet ishin edhe trotuarët
Sigurisht ,sythet e fjetura padyshim prisnin
Të vinte vjeshta e tretë e zverdhur përsëri.

Tek ai blir i vetmuar aty rrugës përbri
Gjethet e zverdhura u kthyen prapë,
S'largoheshin dot, atij i falën dashuri
Lamtumirën e fundit me lot i thanë,
Dhe ikën me erën e vjeshtës
Me enigmën e e bardhë të valës së detit
Tek ai blir për t'u kthyer prapë.

Dhjetor, Durrës 2017

**DO T'I ZGJOJ ËNDRRAT E
BALADAVE**

Tek ajo pemë e dashurisë
Mes lulësh të dy ngecur,
Fluturat ikën pa shpresë,
Dhe flokët e zeza të natës
Të dy na kishin prekur.

Midis nesh ajo natë
Sy përdalë e të zesë,
Puthje e drithërima
La atë mëngjes.
Ishte natë e ftohtë
Që vrau,
Gurët e diamantë të dashurisë.

Ajo më s'u pa, diku iku,
Me veh'te mori trishtimin e ndaloj;
Pa asnjë pendesë, prozhektorët fiku
Në terrin e natës, një tjetër takoj.

Në shtratin e natës, rash të flija,
Një ëndërr e frikshme,
Dashurinë
gëlltiti;
Pabesia e një dore me thikë
Zemrën fortë ma goditi.

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

Isha i pafajshëm ,
s'kisha asnjë peng,
.....?
Nuk e di , unë apo ajo....!

Ëndrrat e jetës i shqeu egërsisht
Tek ai lot që ra në prag.

Ah, qenka botë e çmendur!
Ta dija se në flokët e natës
Thika e tradhëtisë që ngulur,
Dhe atëhere
Do t'i zgjoja ëndrrat e baladave
Të vallzonin në shportën e qërshive.

Zoti më shpëtoi,
Nga ajo thikë e mprehtë;
E lyer me helmin vrastar,
Saqë dhe yjet e shpirtit
Si gjerdan ngelën varur.

Në terrin e asaj nate
Fshiheshin gjithë tradhëtitë;
Ndaj të uroj me shpirt
As vetë o Zot, s'e di!

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

Imazhet e asaj dashurie
Në vetmi kanë mbetur;
Me zinxhirë robërie varur
Tek retë e zeza nëpër qiell,
Dhe tek një lule e vyshkur
E varrosur këtu nën dhe.

Ik, të lutem tradhëti,
Me pika gjaku të tharë
Te tehu i thikës,
Dhe struku diku
Lëre lulen e jetës
Me plagdhimbjen përqafuar.

Durrës, 12 Dhjetor 2017

FLOKËT E BORËS

Si një i marrë vrapova nëpër stinët
Dhe në ditët e tyre mbi to shkela,
E lash pas stinën e pranverës
Tek shkallët e dimrit aty ngela.

Është stinë e dimrit me bardhësi
Me re ngarkuar, të përgjumura,
I thash asaj largohu nga pemët
Do rri dhe pak, nën zë më tha..

Gulçojnë ngarkuar flokët e borës
Sipër degëve me hala të pishës,
Atje fëmijët tretin buzqeshjet, gëzimet
Bashkë me lodrat që zhurmojnë
Dhe... padashur shkrijnë akujt rrugës.

Kristalet e borës, sërish të seç ranë
Të bardhin tapet në tokë shtruanë;
Nga qielli sërish të milona përshëndetje
Flokët e borës me fëmijët përqaftuarë.

Durrës, 16 Dhjetor 2017

TRILLET QË NDEZËN ZJARRE

M'u ulën te pragu i derës
Rrezet e diellit atë mëngjes,
Zgjou nga gjumi, ç'farë pret?
Dhe laji me ujë trëndafili
Sytë e bukur, e të zes.

Po ti moj mike ç'pate,
Që rri ashtu si lule në monopate;
Si zanë më erdhe, plotë fate
Me rrezet e diellit , pive dhe kafe.

Është diell dimri, na përshëndet
Dhe ti moj zanë, mos rri menduar,
Pse ke derte, afrohu me të vërtet!?
Ishin trillet, tek pragu trokitën
Zjarre ndezën në të perënduar.

Durrës, 24 Dhjetor 2017

IMAZHE NJERËZORE

I thashë atë natë lamtumirë imazheve
Dhe befaz të përgjumura ato u zgjuan,
Me mallin e dhimbjes çanë zemrës ugare
Tek njerëzit sërish si prush u përçafuan.

Dhe qielli me yje imazhet zbritën
Nga ajo mbrëmje me dritë hëne,
Qerpikët mbështjellë si lëmsh peri
Në tokë lanë me qimdra imazhe.

Te shtegu i dhive aty mbrëmjes
U tretën imazhet bashkë me yjet,
Dhe vargjet e poetëve mbetën varur
Mes reve si avionët që fluturojnë lart.

Si shiu vallkanik aty seç mbetën
Imazhet e njerëzve në atë natë,
I kërkuan hapësirës , dot si gjetën
Ato diku në fshehtësi kërkonin fat.

Durrës, 28 Janar 2018

TEK STOLI NË PARK

Vrapove tek stoli në park
Pas më ndiqte bleta krahleta,
Tek ajo gonxhe e lules së çelur
Sërish edhe ai u ul te stoli;
Dhe tha: Ti në gonxhe ulur
Kurse unë te stoli ngela.

Ora ecte e dëgjohej tik – taket e saj,
Dhe zemra vrullshëm thoshte Dashuri!
E doja bletën që më ndiqte pas
Prandaj e prita me puthjen e parë,
Tek stoli i drunjtë atje në park
Ndjenjat u zbrazën luleve, e u ndezën flakë.

Durrës, 17 Shkurt 2018.

ÇASTET E ANKTHEVE...

S'e di sa shumë qëndrova
Atëherë në pritje....
Dhe koha fshiu gjymtyrët
E asaj nate.
Ndërsa kodi i pritjes
Ende merrte frymë,
Në gjoksin eshtëror
Atje dikush po trokiste.

Pse kështu ju çaste
Të mbytyra në ankthe
Me sytë e përdalë?
Oh, këtu qënka
Si në shkretëtirë,
Edhe gjumi u bëka
I plogët, i vështirë.

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

Tek sytë e përgjumur
Mëngjeseve me vesë,
Çastet e pritjes i hodha diku
Ashtu pa dashje mbrëmjeve,
Në shportën qiellore
Me yjet takohen aty- këtu.

Më lodhën çastet e pritjes
As vetë nuk di si ta shpjegoj;
Pas tyre vraponin vegimet
Dhe çastet e përgjumura thoshin
Ty e kohës do t'i tregoj.

Durrës, 3 Mars 2018

IKJA...

Ikja, ikja....
Ku?
Për ku!?!...
Një xhaketë e vjetër
Mori arratinë
Dhe...ikja, ikja
Për ku!?

Tek gozhda e vjetër
Ngulur në mur,
Kujtimet ka lënë aty
Një xhaketë e vjetër.

Dhe...si një ditar i hapur
Atje shfaqet si në ekran,
Tek ajo gozhdë e ndryshkur
Ikja në arrati plot mall.

Ndërsa te gozhda e ndryshkur
Varur qëndron dhimbja
Dhe... ikja iku diku...
Në gozhdën e vjetër
Ikja fle në qetësi.

Durrës, 4 Mars 2018

LULET E MARSIT

Me dënes derdhte lotët lulja e marsit
Në trupun e saj ujrak filluan ti shkrijnë,
Nga gjumi dimrak po çelnin manushaqet
Buzëqeshnin gurët,stinët aty rrinin përherë.

Në qiellin kaltërosh fluturonin re të bardha
Dhe mëngjeseve marsiane zbresin pragjeve,
Nëpër degët me lule , retë varur të dardha
Si lotët e nuseve gatuar petalet magjeve.

Të gjitha ditët e stinëve u shkundën
Dhe ranë mbi lulet ngyrë- ndezura,
Si yjet e natës pranverore ndriçuan
Lulet e marsit këngës seç ia thanë.

Durrës, 13 Mars 2018

NË TEL TË KLONIT

Dikur më thoshe,
Ca fjalë gatur si sheqer,
Dhe lotët që derdhe
Pikojnë atje në mermer.

E theve gurin e besës
Në lumin me valë e hodhe,
Flokët me onde të ranë mbi ballë
Të gjitha i zhyte te lumi i valës.

Si dikur sërish ajo vjen
E ndalon si flutur mbi valë,
Çdo pikë loti, shi bie në xham
Mbi supe m'u ule, tek ne ranë.

Dashuria rri çelur në zall
Dhe valën e lumit përfaqon,
Si dikur mbushur plot me mall
Në tel të klonit rri e vështron.

Durrës, 23 Mars 2018

SIKUR TA PREKJA DIELLIN

Mbi qepallë të syrit
Flenë ëndrrat.
Dhe zgjohen ato
Duke mbjellë shpresë.
Tek lulja e jargavanit
Në gonxhe u ulën të flinin prapë.

Nga syri rrodhi loti
Në det pikoi, u bë flori,
Zgjata dorën ta prekja
Aty m'u shfaq nëna.

Nga ai çast m'u zgjuan ëndrrat
Në qerpik të syrit,
I putha ato me radhë
Seç preka edhe diellin
Aty ishte vet nëna.

Në jelek qëndisur
Gonxhe fije ari,
Se nga gjiri nënës
E preka dhe diellin
Ku pinte qumshtin fjala.

Durrës, 15 Maj 2018

PORTA E VJETËR

Tek gurët e portës së vjetër
Dhimbjen e mallin aty i gjeta,
Loti s' ishte tharë, pas kaq vitesh
Eja, bir më tha, me dhimbje
Aty te rrasa e gurit me myshk
Me frymën tënde kam fjetur.

Ja, edhe mani i bardhë te ai kopsht
Ty të ka pritur kaq vite me radhë,
Frutat e ëmbla kurorë në degë
Këngën e mallit zogjtë këndonin
Çdo ditë tek ai parmak
Sigurisht që ti të ktheheshe prapë.

Sipër çatisë së prishur me rrasa
Pjergulla me rrush varur bistak;
Atje kishin ndërtuar fole zogjtë
Dhe luteshin tek parmaku i vjetër
Zogjtë e dallëndysheve ditë e natë.

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

Pas kaq vitesh u ula dhe unë pak
E ndjeva dhimbjen në çdo qelizë;
Te gurët e shtëpisë së vjetër
M'u ndezën si yje vitet mbi gurë
Dhe me këngën e tyre zogjtë bënin lutjen:
O bir, mos ik, por rri edhe pak
Nga ky çast yjet filluan të fshiheshin prapë.

Tek porta e gurtë të shtëpisë së vjetër
Pikoi loti e u bë sërisht dritë ;
Iku diku dhe me vete mori ditëlindjen
Me shpresë se do kthehet përsëri një ditë
Por...aty la gjithë mirësitë.

Durrës, 31 Maj 2018

NJË GJETHE SHELGU

E këputa një gjethe shelgu
Atje buzë përroj në Raven,
Lajthata kishte çelur mbi Selishtë
Ajo më përshëndeti e me buzëqeshje
Më tha:” Mirë se vjen!”.

I zgjata krahët të kapja yjet në qiell
Shirat e vjeshtës të vendlindjes erdhën,
Pa dashje pika shiu në gotë më ranë
Ah,sa dhimbje ndjeva atë çast
Kur pash se gota u mbush me lot.

Është vjeshtë e thashë të mblidhja mollë
Në degë varur qëndronin si yje në qiell,
Të mbushë trastën ashtu si dikur
Çudi, aty gjeta vitet që kisha mbjellë!

Sërish dëgjova mes heshtjes zërat e ujrave
Fëshfërimat e shelgjeve të përroit Raven,
Por edhe këngën e lajthatës në Selishtë,
Pastaj mblodha vitet e mija te ajo shportë
E... nën hijen e arrëve te Leskova jonë
Lam lotin e ëndrrat të qeta ato të flinin.

Durrës, 1 Korrik 2018

ËNDRRAT MË NDJEKIN PAS

Ngado që shkoj ato janë aty
Më ndjekin si qengji manar,
Më buzëqeshin ëndrrat si dikur
Kartolinat që shkruanim në fëmijëri
I ruajmë në shpirt si pala në flamur.

Kalërojnë vitet e thinjat zbardhin mbi kokë
Aty treten kujtimet kur loznim me shokët,
Xixëllonjat e pranverës që bëjnë natën dritë
M'i përshëndetën kujtimet e fshatit sërish.

Sa çudi!Vërtet çudi!
Ah, tek ëndrrat që më ndjekin pas,
Si në pasqyrë m'u shfaqën gjithë dashuritë.

E diel, 26 Gusht 2018

LËKUNDET AI DRU...

Se si më duket ai dru
Me degë e trung i zyrtë tharë,
Nga trupi ai kish' hequr lëvoren
Ndoshta nga plakja e kohës.

Vërtet ai dru lëkundej lakuriq
I vetmuar rrinte aty në horizont;
S'dihet se kush ja kish' grisur kostumin
Ndoshta koha shtrigë e pleqërisë!

Lëkundet ai dru vazhdimisht lakuriq
Dhe gurët lëviznin, aty zhurmonin,
Një fije bari e hollë fjalën e tha
Ca lutje drithëruese loti thumbonin
Mbi trungun lakuriq tingullin la.

Tek ai dru që lëkundej vazhdimisht
Në kopshtin afër e asaj rruge,
Xhaketa e vjetër nga era tundet
Aromën e viteve shpërndante tutje.

Durrës ,19 Shtator 2018

GURI I ATDHEUT

E preka me dhimbje atë gur
Me gishtat e duarve si dritë,
Atë çast ndjeva shumë ftohtësi
Sikur isha në Antraktidë.

As vet s'po dija ç'po ndidhte
E ndjeva dhimbjen e peshës së gurit;
Kërkova prej tij të më thoshte diçka
Jo, kisha humbur nëpër kozmosin e pafund.

Është guri që rënkon i atdheut tim
Ai që s'na ka braktisur ne kurrë;
Edhe kur do largohemi me vdekjen një ditë
Prapë guri i atdheut zgjuar do na rrijë te koka.

E ndjejmë mallngjimin për atdheun
Sa herë që jemi larg prej tij,
Hijerëndë e i dashur ai guri I ftohtë
Gjithë lulet e jetës na i bekon.

E preka gurin e atdhut me dhimbje prapë
Deri në thellësi të eshtrave ndjeva ftohtësi;
I putha gjithë gjymtyrët e atdhut me vrapë;
Ashtu i përlotur në gjirin e atij u ula përsëri.

Durrës, 25 Shtator 2018

VETMIA E LYPSIT

Vraponin si të çmendura gjethet e asaj vjeshte
Të verdha si dylli ato ishin bërë,
Rrugëve të asfaltuara, vraponin nga vetmia
Drejt tyre zgjat krahë e duart një lypsar.

Mbi një mur të vjetër buzë asaj rruge
Varur qëndronte i vetmuar një kungulleshë;
Heshtjen seç ja theu atë ditë u gjende
Zëri i lypsarit e gjethet e asaj vjeshte.

Puiza e erës së ftohtë lypsarit seç i flet
Në pritje të një kalimtari të hapë kuletë;
I puthte gjethet e verdha ashtu pa përtesë
T'i jepnin një kacidhe, lypsarit të shkret.

Vetmia seç ndaloi, po, po atë ditë vërtet
Tek ajo kungulleshë që varur ishte në mur;
Dhe tek gurët e murit ngarkuar me myshqe
Me ato bisedoi e me puthjet i falinin jetë.

Tek ajo kungulleshë varur atje në mur
Me sytë e përdalë nga varfëria pa yjet,
Drejt tyre zgjaste gjymtyrët e duarve,
Aty lypsari i gjorë një ditë vërtet u tret.

Durrës, 28 Nëntor 2018

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

MOS MË THUAJ LAMTUMIRË....

(Kushtuar poetit Sejfulla Malëshova “Lame Kodra”)

Kohët ecin nëpër shtigjet e tyre
Ato me vehte marrin shtërngata shiu;
Dhe valët e lumit Vjosë aty ndaluan
Me vargun e Sejfullait u përqafuan.

Heshtjes memece dhe intrigës kohë
Largohuni prej meje u thoshte gjithmon;
S’pranonte elozhe ,as klithma korbi
Por, as hingëllimat e kalit të egër.

U gërvishë qielli nga retë e hirta
Fjalën e lirë si kuçedër ta gëlltiste;
Por s’mundi dot te “Lame Kodra”
Se rrënjët lisit në shkëmb ishin të forta.

Le të frynte acar i ftohtë
Bashkë me britmat Kaukaz- Moskë;
Me dashurinë e atdheut flakë ndezur në gji
“Lame Kodra” shkroi të bukurën poezi.

Mos më thoni lamtumirë ju lule të qërshorit,
As edhe ju lule të bardha të qershisë;
Tek ai lot që ra mbi atë shkëmb
Era e ngrohtë e fushës së Myzeqesë
Përcjell çdo ditë nga një serenatë,
Por edhe nektarin e dashurisë në vargun tënd.

Durrës, 10 Janar 2019

NATA DHE KUKUVAJKA

Tek ajo çati e vjetër mbi atë shtëpi
Atje çdo natë kukuvajka bënte gjumin;
Sa herë që zgjohej përkëthelte yjet e hënën
E trishtuar ja thoshte edhe vajit të këngës!

E vetme kukuvajka rrudhosur hijes së natës
Dhe myshqet qenë tharë nëpër gurë e rrasa,
Trupit hidhte si këmishë dritën e hënës,
Në vetëmi këngës ia merrte e qante kukuvajka.

Vetmia e zërit të saj ishte ndryshkur
si një lum i thatë mbetur pa ujë,
Aq sa e shtangur vështronte në qiell yjet
E një qen endacak ecte i vetmuar rrugës.

E shkretë kishte mbetur pa njeri
Qante ajo portë e kyçur gjithë ndryshk;
Askush s'trokiste si dikur në atë shtëpi
Veç kukuvajkës me këngën e mykur.

Nga shperëtimat e shpirtit të kukuvajkës
U t'kurr dhe nata e yjet zunë e qanë,
Tani aty dëgjon këngën e vajtimit
Të djegur si drurët e pyllit të tharë.

Durrës, dt. 08 Mars 2019

GURË MARGARITARË

(motiv folklorike)

Si buqet moj lule mali
Këngës seç ja merr thëllëza,
Vashëzo s'të merr gjumi
Në fytyrë të ndriçon hëna.

Gushës varur zinxhir gjerdani
Zbardhon balli si flok 'bore,
Flokët e gjata ngjyrë ari
Dashuritë mbledh në shami dore.

Moj thëllëzë që rri te shkëmbi
Aty ku natën bën gjumë,
Ëndrrat i ktheve në këngë
Prisje që të vija unë.

Lumja ti që ja the këngës
Tek burimi gurë margaritarë,
Pritëm aty i the hënës
Lotët gushës të ishin tharë.

Durrës, 24 Mars 2019

KROJET E FSHATIT TIM

U tretën dashuritë nëpër kohë
Mbi gurë tek ecja tek ai krua,
Zemrës i fola veç një fjalë
Ëndrrat pas kaq vitesh m'u zgjuan.

Erdha prap të pi pak ujë
Pas kaq vitesh aty në krua,
Dhe loti çeli si lule shtogu
Si shtozvalle dashuritë loznin
Mbi supe tek unë pa pushim.

Etjen e mallit me ujë kroi atje shova
Dhe plagët e shpirtit gjetën qetësi;
O kroje të mija, më falni një çast
Lotin e argjent e lash aty në fshat.

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

Dritares së shpirtit butësisht i pëshpëritin
Bashkë me retë e bardha, atje në qiell;
Si lulet e prillit polenin përthithin
Të pathënat e dashurisë në kroje
Ashtu si sumbulla uji yjet ndriçonin
Sërish skutave të shpirtit tim.

Krojet gurgullonin ujë pa pushim
Si dikur lava fytyrën kur isha fëmijë;
Veç tani me flokë të thinjura mbi kokë
Krojet m'u lutën 'Eja prapë biri im!''.

Leskovë, Prill 2019

TE GURËT NË GUMENIK

Te gurët në Gumenik
Ulem e pushova pa frikë,
Shikimin e treta mbi fshat
Dhe me ujë kristal Slepeci
Dritë e fresktë i bëra sytë.

Frynte era lozanjare
Lëkund kallzat e grurit fushës;
Ëmbël më folën gjethet lajthie
Dashuritë m'u derdhën gushës.

Këngës shtruar ja merr thëllëza
Për mbi gur ison mban bilbili,
Lulet çelin nëpër pemë
Sytë mbushur me lot gëzimi.

Putha gurin , dheun e ëmbël
Prapë shikimin hodha mbi fshat;
Tomorrow qëndron përballë
Për ty e shtrenjta Leskovë
Shkrova të bukurën fjalë.

dt. 6 Korrik 2019

TË BUKURËN FJALË...

Në detin e reve të qiellit
Ne ecim rrugëve të pa asfaltuara;
Si kallza gruri dashuritë vrapojnë
Gjithë marrëzitë u fshehën pastaj diku.

Imazhet e jetës , sapo kishin mbirë
Në pemën e jetës, lastarë aty – këtu,
Me të bardhën vello të nusërisë
Retë kishin veshur të bukurën fjalë.

Asgjë s'kish' mbetur nga koha e kaluar
Veç burimi e ujët tregonte të bukurën përrallë;
I putha me etje të gjitha ditët që perënduan
Vërtetë ashtu me radhë, sepse s'isha në përrallë.

Të gjitha shpresat si pëllumba fluturojnë
I puthën retë e bardha si me tërbim,
Dielli i dashurisë, sy i pa fjetur
Me këngën e zogjëve nisen për fluturim.

Sythat e pemëve do çelin përsëri
Të katër stinët m'u futën në gji,
E djeshmja s'mbeti veç përrallë
Retë e bardha të jetës në qiell
Nuse me vello kishin veshur të bukurën fjalë.

Durrës, 26 Korrik 2019

LOT MBI VALË

(Poezi kushtuar nënës time me rastin e një vjetorit të ndarjes nga jeta dt. 4 Tetor 2018)

Mbi atë gur një flutur ndaloi
Dhe lotin derdhi për mbi valë,
Sërisht lulet e liqenit u vyshkën
Kujtimet filluan të flisnin me radhë.

U thashë të më takonin nënën
Merreni me vete lotin atje mbi valë,
Sepse kështu do shuajmë sado pak mallin
Kur të pijë lotin, për mua putheni në ballë.

Durrës, 2 Tetor 2019

VJESHTA DERDHI LOTËT

Një gjethe e verdhë vjeshte

U këput e ra pa dashur nga pema,

Ashtu mbi supe më ra ngadalë

Mos u tremb o njeri i mirë

Erdha të them veç disa fjalë.

Vjeshta filloi të derdh lotët e sajë

Ndoshta po qan ëndrrat në ikje;

Bashkë me gjethet e zverdhura

Të zgjojë dashuritë e stinëve te ne.

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

Degët e pemëve nga era lëkunden
Ato kanë xhelozinë e stinëve që ikën,
Puthjet e ngrohta nëpër degët lanë
Ikën pas erës, lamtumirë gjethet më thanë.

Pas kaq vitesh ëndrrat m'u zgjuan
Loti vjeshtës pikon në gjethet e verdha,
Dhe ne vrapojmë pas tyre në heshtje
Kështu vërtetë qenka edhe jeta .

Dt. 31 Tetor 2019

ZËRI I ATDHEUT

Zëri i atdheut na thërret

në çdo çast,

Me dhimbje dheun e putha

bashkë me një gur.

I hapa krahët si shqiponjë

e në zemër mu ul ngadalë

nga shekujt një flamur.

Ishte gjaku arbëror

Në sfondin e atij flamuri,

Shqiponja në qiell fluturonte

Me vulën e nëntorit 1912 ës.

Dhe sot nëntorët e kuq

të atdheut tim,

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

Nga gjaku i derdhur nëpër shekuj
I dhanë ngjyrën më të bukur në botë!
Zëri i atdheut na thërret
Shqiponja e lirë të fluturojë,
Në qiellin e kaltër arbëror
Sot e për çdo mot.
Dhe ne ecim rrugëve të atdheut
Duke puthur gurët e dheun,
Vala e detit na përqafton,
Që nga Vlora e Prekaz
Të gjitha historitë u shkruanë:
Një flamur , një gjuhë , një Komb
Në gjoksin e nëntorit të Atdheut tim !

Durrës, Nëntor 2019

DET E QIELL NË SYTË E TU

Vështrova sytë e tu
Ata i ngjasonin detit,
Dhe prapë vështrova ata sy,
Sërisht m'u shfaq qielli.
Kjo është vërtetë një mrekulli
Në sytë e njeriut do gjesh.
Pikturën blu të detit
Sigurisht edhe atë të qiellit.
Aty gjeta dhe fjalën e shkruar
Vargu i poetit s'mundet të ishte kuturu;
Dashuritë e botës vallëzonin
Aty në sytë e tu blu.

Durrës, 21 Nëntor 2019

POETI

Kur flet shpirti i poetit
Pena shkruan ABC ,
Fjala bëhet kilometër
Dhe shqiponja bën fole
Për tek shkronjat ABCE ..!

Dt. 28 Nëntor 2019

AKREPAT E ORËS

Dhe ora ndali me të vërtet
Yjet mbyllën sytë e qielli u err,
U drodh toka nga ai tërmet
Vëlët e detit u zhytën nga ai tmerr.

Ishin ditët e fundit atë nëntor në mëngjes
Me drithërima zërash e lotësh trokiti,
U zverdh dita e bari me ves
Atje nën rrënoja betoni lutej ajo shpresë.

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

Rëkonte edhe dielli ashtu me të vërtetë
Fytura njerëzish gri ecnin si zogjtë në fole,
Edhe yjet u përplotën në mure e çati
Heshtja- heshtëte, shpresën kërkonte
foshnja nën dhe.

Akrepat e ores ashtu në heshtje
Yjet e dielli kërkonin prap shpresë,
Ecte si një i marrë edhe ai tërmet
Lindi dhe fëmija, prap na dha JETË!
Durrës, 10 Dhjetor 2019

KËNGA JEHON ME YJET

(Kushtuar këngëtares Nexhmije Pagarusha)

Në buzëqeshjen tënde

Lexohet e dëgjohet kënga për atdheun,

Dhe tingujt e saj të ëmbël

Puthen me gurët e dheun.

Edhe yjet në qiell po vajtojnë

Gjithë tingujt e këngëve për një çast
ndaluan;

Nexhmijes i dhuruan lotin e luleve

E bashkë me ato u “zgjua” duke kënduar !

Zëri i saj si flutur krahshkruar

Në gonxhen me flatra hapur të atdheut,

Në heshtje duke buzëqeshur

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

Si një meteor këngët aty kishin mbetur.

Imazhi yt bashkë me këngën jehon

Në breza e shekuj do japi dritë,

Dhe loti dhimbjes së shkurtit u bë diell

Me këngën në buzë Nexhmija

I tha vdekjes “ik!”.

Vjen një ditë edhe guri tretet

Por kënga e saj bashkë me yjet,

Atje në zemrën e atdheut

Emri e kënga e Nexhmijes

E përjetshme në shekuj do mbetet.

Durrës, 07 Shkurt 2020

Shtigjet e mjegullës

Vështrimin e treta tutje në kohë,
Dhe eca ashtu drejt shtigjeve diku,
Nuk desha ta prekja të bukurin shteg
Aty ngadalë më uli të rrija në prehër.

Ju shtigje të gjata të jetës sonë
Sa shumë ju na keni dashur,
Tek ju çdo ditë ne kuvendojmë
Si kuajt e egër shtigjeve të mjegullës ne rrimë.

Thinjat e bardha netëve të errta vezullojnë
Si mjegulla nëpër pyje në gjelbërim,
Ashtu edhe jeta qënka vërtetë vetëtimë
Shtigjeve të mjegullës kërkon përjetësinë.

Durrës, 1 Mars 2020

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

COVID-19

Dhe sot gulçon anembanë globi
Frymarrjen kërkon ti marrë,
Si një i përbindshëm nëpër kontinente
Jetën tonë kërkon ta ndali!

Atje në pragun e hënës
Yjet ulen e s'bëjnë gjumë,
Koronavirusi- i çmenduri i shekullit
Do të shporrim o i paudhë.

Enigmat e të panjohurës galektikë
Trille të kohës mbushur me fosile;
Nuk e ndalon dot frymarrjen e globit
E nesërmja do flasë me dritën e Jetës !

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

Në sytë e grisura të kohës sonë
Dhe ti verbri i shekullit COVID- 19,
Në vijëzime pllakash guri të thyera,
Në kasafortë kujtimesh, i mbytur do mbetesh.

Durrës, 23 Mars 2020

Thënie filozofike (pentagrame)

“Njerëzve dritshkurtër bëju mirësi sa të duash, një ditë ata do mbjellin gjemba në kopshtin e mirësisë!”

“Kush ngre zërin tej masës së llogjikshmes, i mungon dituria intelektuale e profesionale!”

“...Në do të jesh i ditur, bëj mik librin e lexoje atë!”

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

“Një zemër e gëzuar, mbjell dashuri!”

*‘Shtëpia pa njeri, si kopeja pa
bari!’*

*“Pika e djersës në punën e
ndershme, rrjedh si burin
floriri!”*

Xh. Cirongu, Nëntor 2019

Autobiografi

Ka lindur në fshatin Leskovë, Tomorricë-Skrapar në vitin 1959. Arsimin fillor e të mesëm e kryen në vendlindje, viti 1981. Vazhdoi për Kulturën Masive (Degën e Librit) në Korçë, e kryen atë shkëlqyeshëm në vitin 1990. Pranë gazetës "Jehona e Skraparit" ka kryer kursin e gazetarisë. Nga viti 1978 deri më 1987, ai ka bashkëpunuar me Kabinetin e Gjuhësisë së rrethit skrapar, (sektorin e leksikologjisë dhe leksikografisë). Krijimtarinë e ka nisur herët, që kur ishte nxënës në bangat e shkollës 8-vjeçare. Fillimisht ka botuar në revistat "Fatosi" e "Pionieri". Më vonë, prej vitit 1976 e deri sot, shkruan e boton në gjithë medien e shkruar dhe atë elektronike. Në vitin 1984, merr çmim të parë në festivalin kombëtar të këngës për fëmijë që u organizua në qytetin e Shkodrës; me titullin e këngës "Ligjëron nëna për djalin" të kompozuar nga Hajri Xhamëni. Po kështu, ka shkruar tekste këngësh folklorike. Kënga me motive të dasmës së krahinës së Skraparit "Moj

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

nuse, faqe simite" merr çmimin e dytë në festivalin folklorik të Gjirokastrës. Është autor i katër këngëve, që janë hedhur në disk të kënduara nga këngëtarët popullorë Asllan Ibro e Bajram Haxhillari, në vitin 2009 dhe 2013 - ën. Tekstet e këngëve iu kushtohen dëshmorëve të Vlushës (të vrarë në luftën e Dytë Botërore-1944); si dhe Astrit Suli, - Dëshmor i Kombit, i cili dha jetën për çlirimin e Kosovës në vitin 1999.

Në vitin 2009 merr pjesë në konkursin letrar për tregimin më të mirë të organizuar nga shtëpia botuese "Ada" dhe revista "Obelisk", ku tregimi me titull "Hijet e harresës" hyn në antologjinë "Tapeti i tregimit". Me poezinë "Nëna" merr pjesë në antologjinë "Lotët e Virgjër" me autor Agim Mato – Fatmir Terziu, botuar nga "APCO" 8 mars 2012 në Londër. Ku midis 143 poetëve nga gjithë trojet shqiptare është edhe emri i poetit Xhevahir Cirongu. Ka marrë pjesë me poezitë e tija të botuara në 10 antologjitë me poezi që ka botuar shtëpia botuese "Muzgu" në Tiranë. Po kështu, autori Xhevahir Cirongu është edhe redaktor e korrektor i mbi 90 librave. Poezitë e Xh. Cirongut janë vlerësuar edhe nga kritikë e studiues të ndryshëm. Të tillë janë Faik Xhani – Tiranë e Pjetër Cara – Durrës, i cili vlerëson

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

poezitë të libri me titullin "Bisedë me poezinë" midis autorëve të tjerë edhe krijuesin e trevës së Skraparit, poetin nga Leskova e tomorricës, Xhevahir Cirongu.

Ka punuar në Kulturë e telekom deri në vitin 1990. sot shkruan në mediat e shkruara dhe ato elektronike në të gjitha fushat gazetareske e letrare. Deri tani është autor i 12 librave. Ka në proces botimi edhe 4 të tjerë me tematikë të ndryshme. Deri më sot, publicisti, poeti e shkrimtari Xhevahir Cirongu, në fushën e gazetarisë ka botuar mbi 4 mijë artikuj të fushave të ndryshme në publicistikë e letërsi. Jo vetëm kaq, Xhevahiri është edhe një kritik e vlerësues i mirë letrar. Janë me dhjetra kritika vlerësuese që u ka bërë shumë autorëve rreth librave të tyre, në Shqipëri e Kosovë. Ai di të qëndis bukur fjalën e shkruar dhe të bëjë vlerësim real që mirëpritet nga lexuesi i mirëfilltë letrar. Ka bashkëpunuar dhe është bashkëpunëtor i shumë gazetave e revistave brenda dhe jashtë vendit. Ka botuar e boton shkrime në revistat: "Fatosi", "Pionieri", "Shqiptarja e re", "Hosteni", "Obelisk", "Dituria", "Metafora", "Vegime letrar", "Pavdekësia" "Krahu i shqiponjës" etj. Por edhe në gazetat "Jehona e skraparit", "Luftëtari", "Puna", "Zëri i rinisë", "Bulevard", "E vërteta",

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

"Ndryshe", "Zëri i popullit", "Republika", "Kushtrim brezash", "Telegraf", po edhe te "Drita", "Muzgu", "Dielli i Tomorrit", "Nacional", "Dëshnica", "Zëri i Gollobordës", "Tirana observër", "Fryme e Re" por gjithashtu tek "Lajmi", "Bota sot" në Kosovë, etj. *Në vitin 1986 vlerësohet me Medalien "Naim Frashëri". Gjithashtu, Xhevahiri merr pjesë në "Ditët Naimiane" që organizohet për çdo vit në Përmet, i cili përfshihet me një poezi në këtë antologji. Po kështu merr pjesë në antologjinë ndërkombëtare për mesdheun me dy poezi kushtuar pemës së ullirit, i cili përfaqëson Shqipërinë. Njëra poezi vlerësohet si poezia më e mirë e kësaj antologjie që botohet në Itali në vitin 2017 në gjuhët italisht, fërngjisht dhe shqip. Poezitë e këtij autori, përveç përkthimit në gjuhët, Anglisht, Italisht, Fërngjisht, janë përkthyer edhe në gjuhën Arabe e Kineze. Eshhtë antar i Klubit të Shkrimtarëve e Artistëve - Durrës.*

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

Botime të autorit:

- 1.Kush ia shkeli syrin Ildës, poezi (2005)
- 2.Tomorrica zemra jonë (bashkëautor) ,monografi (2009)
- 3.Shpirtit i thërres, poezi (2009)
- 4.Mall nga oqeani, publicistik, poezi, tregime (2010)
- 5.Misteri i një graje, tregime (2010)
- 6.Bisqet e gjakut, monografi histori (2013)
- 7.Kosmogonia e një poeti kosovar (bashkëautor) përmbledhje kritika vlerësuese letrare (2014)
8. Pena e Bedri Tahirit përjetëson lavdinë tonë kombëtare , histori (Bashkëautor) (2015)
9. Kënga e lotit, poezi (2016)
10. Livadhi në mal , tregime për fëmijë (2017)
11. Tomorri qiell perëndie (publiçistikë) (2018)
- 12 . Udhë në kohë... (publiçistikë) (2019)
- 13.Sikur ta prekja diellin, poezi, (2020)

Fund

Durrës, Nëntor 2019

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

PËRMBAJTJA

Fq.

Në brigjet e shpirtit.....	4
Puthjet aty ngelën.....	5
Eshtrat e pëllumbit.....	6
Te lulet e blirit.....	8
Puthjet lamë pas.....	10
Kohë e krisur.....	11
Mot e jetë në liri.....	13
Ditëro Agollit.....	14
Tingulli i fjalës.....	15
Koha shtrigë.....	16
Çapitet xhelozia.....	18
Ndjenjat e stinëve.....	19
Eja, afrohu.....	20

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

Kohan ë univers.....	21
Më foli lulja begonja.....	22
Ç'patën yjet e natës.....	23
Liqenet e syve.....	24
Alepo, Alepo.....	25
Atje anijet flenë.....	26
Na pret e bardha valë.....	27
Metafora e fjalës.....	28
U ndezën neonet.....	29
Hesht.....	30
Më dehu era e vjeshtës.....	32
Na fton shekulli i ri.....	33
M'i vodhi gjethet.....	34
Do t'i zgjoj ëndrrat e baladave.....	35
Flokët e borës.....	38
Trillet që ndezën zjarre.....	39
Imazhe njerëzore.....	40

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

Tek stoli në park.....	41
Çastet e anktheve.....	42
Ikja.....	44
Lulet e marsit.....	45
Në tel të klonit.....	46
Sikur ta prekja diellin.....	47
Porta e vjetër.....	48
Një gjethe shelgu.....	50
Ëndrrat më ndjekin pas.....	51
Lëkundet ai dru.....	52
Guri i atdheut.....	53
Vetmia e lypsit.....	54
Mos më thuaj lamtumirë.....	55
Nata dhe kukuvajka.....	56
Gurë margaritarë.....	57
Krojet e fshatit tim.....	58
Te gurët në Gumenik.....	60

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

Të bukurën fjalë.....	61
Lot mbi valë.....	62
Vjeshta derdhi lotët.....	63
Zëri i atdheut.....	65
Det e qiell.....	67
Poeti.....	68
Akrepat e orës.....	69
Kënga jehon me yjet.....	71
Shtigjet e mjegullës....	73
Covid- 19.....	74
Thënie filozofike (Pentagrame).....	76
Autobiografi.....	78
Botime të autorit.....	82

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Cirongu,
Sikur ta prekja diellin: poezi / Xhevahir Cirongu;
Red.Lorenzo Manca.
Durrës: Jozef, 2020
106 f.; 14.5 x 21 cm.
ISBN 978-9928-317-22-3

1.Letërsia shqipe 2. Poezia

821.18-1

Mars, 2020

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi

Xhevahir Cirongu – Sikur ta prekja diellin, poezi